



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____/____/202__

PËR
NDRYSHIMIN E PIKËS 1 TË VKB-SË NR.11, DATË 30.04.2025 “PËR DHËNIEN E
DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË
KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI
PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023
TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN
RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM,
BASHKIA Durrës”, PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL.

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullës kombëtar”, VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM nr. 1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit Nr. 1667/1 Prot, datë 12.03.2025 si edhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë dhe shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të VKB-së nr.11, datë 30.04.2025 “Për dhënie e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të Kkt-së “për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”, për shkak të një gabimi material, si më poshtë vijon:

2. Dhënie e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore prej 8652.45 m² (pronësi private) nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të Vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së "Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës".
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtör

Alneida Rroshi

KRYETAR

Emiriana Sako